

Dituri Meçi Dizdari

Ne të rrugës Selvia...

Lirikat e mia

BOTIMET TOENA

Tirana

Botuese: Irena Toçi

ISBN 9789928376909

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësia”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

*...të kem sërish atë pasuri netësh
hëne të plotëndjesie që lanë përgjithmonë
në mendje një kujtesë njolle drite...*

Në shtëpinë ku u rrita



Vëllimi poetik

PREJ ANDEJ

1994

*Papritur një pulëbardhë
fluturoi në shpirtin tim qiell.*

Pulëbardha



PËR VETEN

U deha, e tëra u deha
Trupin tim asfare s'e ndieja
Udhëve tërë dritë, të pashkelura ecja
Dhe ruaja gjithçka, mos më thyhej brenda.

1994



PËRJETËSISHT

Një skute të errët prisja
Të zbrazët, plot vetmi të ftohtë
Dimër ishte
Flokonte dëborë
Dhe mendimi, dhe sytë, dhe shpirti dhe buzët
Brenda shpirtit tim mërmërinin
Një ditë pa të parë
Një zog përplasur shpirtit
Një lumë i ngrirë
Pa dashurinë një shekull
Një shekull vetmi

Fajtori vetë
Vetë gjykatësi
Por ti erdhe
Shkallëve të yllit tonë ngjiteshim
Ne, që lageshim aty

Na ngrohu reaksioni njerëzor
Na ndezi gjakun afsh'i pranverës
Veten ia dhamë ajrit të kthjellët
Ishim një mijë bulëza uji
Çelur një mijë gjetheve
Një lumë vërshues me lot të kaltër drite
Një jetë që i përkisnim qiellit
Përjetësisht



DËGJOJENI KËTË GRUA

Duar dhimbjesh të acarta ndër kyçe
Shpirt rrënduar nga pesha e dashurisë
E kërrusur prej peshës së globit - gruaja

Ngjeshje mizore lëndimesh
Në trup, në shpirt
Mrekulli vuajtjesh rrit njerëzimin

Shqetësim dhe mendim i pafund, dhimbja e saj
Me krahë të fortë ku mban
Të Triumfit Hark

Dëgjojeni këtë grua

Me shpirt hapësire fluturimesh magjike
Me trup ku harbon vetë dashuria
Që di çdo gjë dhe asgjë për vete
Që ndien gjithçka dhe asgjë nuk pret
Që jep veten dhe s'kërkon asgjë



PEIZAZH

E pe si trokiste zemra
Kur preke buzëqeshjen,
Se puthja ime i ngjante një fladi
A e pe?

E pe se sytë e mi kishin dritën tënde
Se dora ime mbi flokë të ish
se pëshpërisja emrin tënd si fëmijë i vogël
që udhëve të jetës të ecë nis?

E pe peizazhin tim të ngrohtë
që lind e perëndon tek ti?
Si diell në muzgun e mbrëmjes.



PËRJETIM

Hëna në kupolën e përjetimit tim
E ndezur në pikëllimin e saj
Gjumi im i prishur
Në copëra yjesh shpërndarë



PULËBARDHA

Papritur një pulëbardhë,
fluturoi në shpirtin tim qiell,
dhe syrin gjithë shqetësim asaj ia pashë,
krahët që i tundte, gjithnjë pa pushim,
e krejt ashtu pa kuptuar,
në bardhësinë e saj unë rashë.

E vinte ashtu rrotull, e vend jo, nuk po zinte,
e unë krejt e hutuar, s'e ftova që të rrinte.

Por jo... ky qiell i bukur, nuk ishte për atë zog,
erërat e kohës, në të kishin fryrë,
prandaj u soll teposhtë ashtu si një lot,
papritur iku më la,
sikur kurrë të mos kish hyrë.

Papritur një pulëbardhë
fluturoi në shpirtin tim qiell.



PREJ ANDEJ

Det dëshirash zgjon shpirti im,
det dëshirash të marra.
Si një fëmijë luaj aty.
Prej andej si yll qielli
shoh gjithçka.

Prej andej
rruga është më e qartë
më e bukur
më e gjatë është ecja
prej andej.

Mrekullisht kam mbërritur



NDARJA

Skaj i dashurisë sime të dhimbshme,
degë e lisit thyhet prej saj,
gjithçka të ftohtë, pa jetë mbartin ditët
i saj, pus i thellë jam.



DREJT TEJE

Kalova mbi një vuajtje
Mbi një njohje të vetes
Apo mosnjohje të saj
Mbi një dhimbje në molekulën e gjakut
Mbi një ëndërr të vjetër
Të re
Mbi një puthje të harruar
Pa faj të dëshiruar
Mbi një urë të gëzimit tim të çmendur
(Sa i çmendur e di koha)
Për arsyen më të bukur të botes,
Që të vij tek ti



DO TË TAKOHEMI I DASHUR

Jemi dashur qiellit të shpirtrave tanë!

Do të takohemi i dashur
Qielli i pritjes po mbyllet
Vitet e tij sekonda janë
Unë tek ti një yll

Mos u zemëro i dashur,
Nga përplasja e yjeve
Rritet dritë e ndriçimit
Ndaj ti s'më sheh...

Aty jam pranë
S'do largohem
Do ndrij e do të tretem te ti

Do të takohemi i dashur!
Në yllin tonë
Në dritëzimin e tij
Takim kemi lenë.



MBRËMJE

Shpirtin freskon fladi blu
Ar i hënës më shndrit
Në zjarr yjesh ndjej dashurinë
Heshtjes së mbrëmjes, ti



JETA

... Më në fund
U kujtua për mua
Më në fund...

Shkëmbit rrokullisi
Dhe thërrmoi gurët e saj
(Funde ankthesh që s`janë më)

.....

Mrekullitë pulsojnë tani
Gjakun tim
Deteve pa fund dallgëzoj
Poezia...

.....

.....

Tani jam valë dritash
Ku më agon e nesërmja
S`e di...
Fillim bukurish pa fund.



KU JANË ZGJIMET ME AG TË BARDHË

Ku janë zgjimet me ag të bardhë,
në sytë e mi?
Në liqenet e tyre,
uji është pasqyrë e shpirtit që dhemb.

Thellësitë pa fund,
nuk i freskon dot më,
flad i kohëve të bukura.
Mes shkurresh lotqerpikësh syri im.
Ku janë zgjimet me ag të bardhë ?

1994



Vëllimi poetik

HOMO SAPIENS

2001

*Syqielli ngjyer në Valbonë, larë,
rrebeshet ndal, stuhitë, erën.*

Fioralbës



SA HERË KAM MENDUAR

Thuamë, si do të fiksohet çasti
në syrin tënd,
në vështrimin tim?

Zog i etikës, a do të mund të fluturojë aty?

A do të rrjedhë fjala ullukut të arsyes,
apo cipën përjetimit do t'ia heqë, zbulojë?

Nga zjarri i befshëm në vatrën e mallit
a do të mund ta çlirojmë veten,
... dhe urat njëra tjetrën të djegin?

A do të vdesë mbrëmja në prehër të agut...
... kur papritur hapat tona të përballin gjurmët?

Sa herë kam menduar...



A MUND TA SHOHËSH...

Pezull që nuk e di, ku dhe kur, vërtitet endet,
si magji që kurrë nuk e kuptova
o nuk desha ta kuptoj, vjen e ulet...
Gjendje që gjakon në trup prelude ndjesimesh,
me mua njehsohet, lëvrin.

Vetëm tani kapilarët e shpirtit çelin udhët,
semaforët e kuq të dhimbjes drithërojnë,
kamxhik mbi trupin e lidhur, koshienca
vetveten vret.

A mund ta gjesh tek unë, veten tënde?

Të zjarrtë, të ftohtë, herë ngre krye më vret,
herë tjetër loz dhe në atë lojë më humb,
pastaj strukesh diku e fshihesh...
Gjithçka ku është dhe s'është je, baret,
në kufijtë e ëndrrës ku ajo zë fill
dhe mbaron, shfaqesh, del prej meje,
për të hyrë përsëri aty, pa më pyetur.

A mund ta shohësh tek unë veten tënde?
Si dritën e bardhë që çmëson sytë
e bën të ndjehesh ai, që dikur ke qenë
por që e ke harruar,
si lulet e mia me aromë, të harruara
në ditën tënde të ikjes.

1996



AH, KUR KËNDOJE TI

Ti nuk e di se hëna këtu këputet si një kopsë dhe bie
ti nuk mund ta dish si hyn jeta përmes një vetësie
që nuk është më,
si humbtretën ëndrrat pa u parë...
si shfaqin netët shtratin tënd pranë pishinës,
një dritë sysh të përkund gjumin e lodhjes së rëndë
një bukuri përballë bukurisë.

Jo, ti nuk mund ta dish!

Të mos shohësh dot një përkryerje, të verbojë,
si thërrmohen në heshtje kristalet e dritës,
pastaj një dritësi e plotë...
një nga një t'i gremisësh të gjitha në humbëtirë të
vetes,
të dish mirë se gabon,
të ndjesh krim kur vrasje nuk ka
me dhëmbët e traditës të shqyesh njerëzoren...

A e mban mend rrëzimin e mbrëmjes mbi pishinë
kur ti i lagur dridheshe,
gëzimin e çmendur pas çarkut dritësor që ndjell jetë,
plazhin e vonët, naivitetin tim...
...nuk mbaj mend a kish yje nata.
mëngjeset perëndimet me ty, pa ty,

atë botë, magjinë e jetuar,
të përjetshmen unazë të këputur, të verdhë që lidh
qiejt
...nga ajo që je të fshihesh thellë në djepin e vetes,
të mbytësh foshnjën,
puthjen e vetme në faqen tënde
dhe next year, lotët...

Të kesh fatin të duash...

Zbret nga ëndrrat yjeshkrumbuara të një vajze,
rrjedh nga qumështi hënor i gruas,
nga shpirti i mirësisë, që jo për këdo, geni gatuan
nga kënga e buzëve të tua, zbret.

Ah, kur këndoje ti,
të vdekur mjellmën, rivdisja!

Antalia-Turqi, 1997

